

**AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR "WorkOver" SH.P.K.**

**KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

NENI 1

Në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, sot, më datë 31.01.2024, me vullnet të lirë, Ortaku:

1. **Z. Ermir Avdaj**, i biri i Mehdi-it, lindur më 21.07.1978, në Rrëshen, banues në Tiranë, identifikuar me pasaportën me nr. personal H80721110Q, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

si themelues i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

**NENI 2
EMRI**

Emri i shoqërisë është "WorkOver" shpk.

**NENI 3
FORMA**

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortaku do të përballojë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara për kapitalin.

**NENI 4
SELIA**

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Tiranë, Bulevardi "Bajram Curri", Ndërtesa 128, Hyrja 26, Kati 4, Ap. 190.

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 5
AFATI**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.

**NENI 6
OBJEKTI**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Shoqëria ka për objekt kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në baze të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti: Ofrimin e shërbimeve të ndryshme për shoqëritë që kryejnë operacione hidrokarbure në kërkim, prodhim dhe/ose zhvillim. Keto shërbime do të fokusohen por pa u limituar në shërbimet me sonda apo mjete të tjera të ngjashme, riparime dhe mirembajtje të ndryshme



punime ndertimore, sherbime mjedisore, venie ne dispozicion te mjeteve teknologjike, makinerive, pajisjeve dhe automjeteve, sherbime te transportit te naftes apo fluideve, injektimit te ujrave nentokesor, pastrimit te mbetjeve hidrokarbure, furnizimin me materiale e pajisje te ndryshme, studime, projektme, sherbime ndermjetesimi etj. Studimin, projektimin, mbikqyrjen dhe ndertimin e objekteve civile, ndertesave, rugeve, urave, autostradave, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, linjave nentokesore e mbitokesore per energjine dhe telekomunikacionin, centralet dhe hidrocentralet, objekte turistike, rrjeteve inxhinierike, objekteve industriale realizimin e studimeve urbane, kryerjen e te gjitha restaurimeve. Zhvillimi dhe shfrytëzimi i projekteve të ndryshme mekanike. Konsulencë lidhur me inxhinierinë mekanike. Ofrim shërbimesh me agregatë dhe mjete teknologjike. Shërbim i pastrimit, trajtimit dhe injektimit te ujërave pas proceseve teknologjike. Shitje apo dhënie me qira e aseteve, automjeteve dhe motomjeteve. Tregëtim produktesh nënproduktesh dhe pajisje për sektorin e nxjertjes dhe përpunimin e hidrokarbureve.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë. Kuota e kapitalit themeltar të shoqërisë është e ndarë dhe nënshkruar si më poshtë:

- 1. Z. Ermir Avdaj**, në cilësinë e ortakut themelues, zotëron **100%** të kapitalit themeltar, ose 1 kuotë të barabartë me vlerë prej 100,000 (njëqind mijë) lekë në kapitalin themeltar.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjeherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 8 ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese do të rregullohet sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe Statutin e shoqërisë.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 9

Administrator i parë i shoqërisë është z. Ermir Avdaj, pajisur me pasaportën me nr. personal H80721110Q, i caktuar për një afat 5 vjeçar.

**THEMELUES
Z. Ermir AVDAJ**

